



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d**, të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 24, paragrafët 1, 2, dhe nenit 25, paragrafët 1, 2, dhe 6 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajjtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 10/03, prill 2019), dhe të nenit 33.2, shkronja **a**, dhe nenit 34.1, shkronja **d**, të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 25.07.2022, merr këtë

### **V E N D I M**

- I. MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajjtshme komunale me pronën e paluajjtshme në pronësi të Jeton (Ramiz) Hysenit, Faton (Ramiz) Hysenit dhe Driton (Ramiz) Hysenit.
- II.** Vendimi i cekur në pikën I nënkupton këtë këmbim:
1. Prona e paluajjtshme që merret nga ky këmbim, është pjesa e parcelës me nr. 01775-0, me sipërfaqe prej: 111m<sup>2</sup>, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914059-01775-0, Zona kadastrale Prishtinë, në pronësi të Jeton (Ramiz) Hysenit, Faton (Ramiz) Hysenit dhe Driton (Ramiz) Hysenit, me destinim - infrastrukturë rrugore, sipas Planit rregullues "Prishtina e re – Zona Perëndim", i miratuar me Vendimin 01. nr. 35-186850, dt. 02.10.2013, të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.
  2. Kurse prona e paluajjtshme komunale, P.SH. – rrugë, që do të jepet në këmbim, ka këto karakteristika: pjesa e parcelës nr. 01778-0, sipërfaqe prej: 111m<sup>2</sup>, Certifikata e pronësisë nr. P-71914059-01778-0, Zona kadastrale Prishtinë, me destinim shtrihet brenda vijës rregulluese, ndërtim sipas Planit rregullues "Prishtina e re – Zona Perëndim" i miratuar me Vendimin 01. nr. 35-186850, dt. 02.10.2013, të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.
- III.** Këmbimi i pronës së paluajjtshme është bërë për arsyet se prona e lartëcekur shfrytëzohet për interes publik, dhe kostoja financiare e shpronësimit është shumë e lartë.
- IV.** Para shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajjtshme të Komunës dhe vlerësimit të pronës private, ku do të përcaktohen sipërfaqet e sakta të këmbimit.
- V.** Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajjtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarëve të parcelave kadastrale që do të këmbehen pas vlerësimit të pronës nga organi kompetent.
- VI.** Pronat e paluajjtshme komunale që do të këmbehen, të përshkruara në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohen në librat kadastralë të Komunës.

VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtorja e Pronës dhe Drejtorja e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.

VIII. Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:

- skica grafike,
- kopjet e planit dhe
- certifikatat e njësisë kadastrale.

IX. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT  
01-463/03-177505/22, më 26.07.2022

KRYESUESI I KUVENDIT

Fehmi Kupina



## Arsyetim

Pronari i pronës private, sipas kërkesës nr. 13-464/01-83091/22, ka kërkuar që të kompensohet për pronën private e cila shfrytëzohet për interes publik – rrugë, gjegjësisht është parcela nr. 01775-0, me sipërfaqe prej: 111m<sup>2</sup>, Zona kadastrale Prishtinë, në pronësi të Jeton (Ramiz) Hysenit, Faton (Ramiz) Hysenit dhe Driton (Ramiz) Hysenit, me destinim “interes publik – rrugë”, sipas Planit rregullues “Prishtina e re – Zona Perëndim”, i miratuar me Vendimin 01. nr. 35-186850, dt. 02.10.2013.

Propozimi për inicimin e këmbimit të pronës komunale, P.SH. – rrugë, me pronën private të cekur në pikën II, është bërë për arsye se prona e lartcekur shfrytëzohet për interes publik, dhe kostoja financiare e shpronësimit është shumë e lartë, andaj për t’u shmangur pasojat e larta financiare që mund të vijnë nga proceset gjyqësore, është propozuar që prona e lartcekur të këmbëhet me pronën komunale, gjegjësisht me pjesën e parcelës nr. 01778-0, sipërfaqe prej: 111m<sup>2</sup>, Zona Kadastrale Prishtinë, me destinim shtrihet brenda vijës rregulluese ndërtim sipas Planit rregullues “Prishtina e re – Zona Perëndim”, i miratuar me Vendimin 01. nr. 35-186850, dt. 02.10.2013.

Procedura e këmbimit të pronës komunale me pronë private është duke u zhvilluar në bazë të nenit 25 të Ligjit nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 10/03, prill 2019).

Andaj, duke u bazuar në dispozitat ligjore të cilat janë të përshkruara në pjesën hyrëse të këtij propozimi dhe në shkresat e lëndës, propozojmë që të bëhet këmbimi i pronës komunale me pronë private, siç është përshkruar në pikën II të dispozitivit të këtij propozimi.